

VENDIM
Nr. 480, datë 25.7.2012

PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR TË EMERGJENCAVE
“PËR REAGIMIN NDAJ NDOTJEVE DETARE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 32, 398 dhe 401 të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 20 të ligjit nr. 8905, datë 6.6.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja dhe dëmtimi”, të ndryshuar dhe të ligjit nr. 9692, datë 8.3.2007 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare Detare “Për përgatitjen ndaj ndotjes nga nafta, reagimi dhe bashkëveprimi (OPRC) 1990””, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e planit kombëtar të emergjencave “Për reagimin ndaj ndotjeve detare në Republikën e Shqipërisë”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD), Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave dhe institucionet e tjera shtetërore, si dhe organet që kanë interesat e tyre në det për kontrollin dhe zbatimin e këtij plani kombëtar.

3. Ngarkohet QNOD-ja të bashkërendojë punën me institucionet e përmendura në pikën 2 për plotësimin e anekseve të nevojshme brenda 15 (pesëmbëdhjetë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha